

ÇFARË DO TË BËJ KUR PERSONI IM I DASHUR TË JETË NË HOSPIS (HOSPICE)?

Kujdesi për një person të dashur me sëmundje të rëndë është një nga rolet më të rëndësishme që mund të keni. Si kujdestari kryesor i personit tuaj të dashur gjatë kohës që është në hospis, detyrat tuaja variojnë nga blerja e ushqimeve dhe gatimi i vakteve deri tek organizimi i takimeve mjekësore dhe ofrimi i kujdesit në praktikë si larja e tij dhe ndërimi i çarçafëve.

ÇFARË SIGURON HOSPIS PËR PERSONIN TIM TË DASHUR DHE FAMILJEN TONË?

- Barnat që nevojiten që personi të jetë rehat
- Pajisjet dhe furnizimet mjekësore
- Kujdes afatshkurtër spitalor në institucione të miratuara për simptomat që nuk mund të menaxhohen në shtëpi
- Kujdes të përkohshëm larg shtëpisë, i quajtur gjithashtu si kujdes i përkohshëm ndihmës.
- Mund të ofrohen shërbime të tjera plotësuese falas, si vullnetarë, terapi muzikore, masazh dhe terapi me kafshë shtëpiake.

MIRËQENIA JU AJ ËSHTË E RËNDËSISHME.

Është normale të ndiheni të izoluar dhe të rënduar nga përgjegjësitë e ofrimit të kujdesit. Mund të ndiheni të pasigurt sa i përket vendimmarrjes që vjen me përgjegjësinë e kujdestarit. Mund të dyshoni në aftësinë tuaj për t'u kujdesur për personin tuaj të dashur.

SI MUNDET T'JU NDIHMOJË HOSPISI?

Profesionistët e hospis mund t'ju tregojnë se si të bëni shumë prej këtyre detyrave të rëndësishme. Në dispozicionin tuaj do të jetë një ekip i përbërë nga një infermier, një mjek, një punonjës social, ndihmësinfermierë dhe një përfaqësues fetar për kujdes shpirtëror, i cili do t'ju ndihmojë me përgjegjësitë fizike të dhënies së kujdesit dhe do t'u ofrojë mbështetje për nevojat tuaja emocionale. Ju mund të kontaktoni me ekipin tuaj të hospis kurdo që t'ju nevojitet ndihma e tyre.

Hospis mund t'ju ndihmojë gjithashtu të zhvilloni një plan për të plotësuar nevojat tuaja dhe për të gjetur burime të tjera. Mund të jetë shumë e dobishme të kërkonti mbështetje nga familjarët, miqtë, kisha, ose grupet tuaja sociale.

ÇFARË DUHET TË DI TJETËR?

Regjistrimi i personit tuaj të dashur në hospis është fakultativ. Kujdesi në hospis mund të anulohet ose të ndryshohet për çfarëdo arsyeje dhe në çdo kohë.

Flisni me familjen dhe miqtë tuaj në lidhje me hospis. Ndarja e kësaj broshure mund t'ju ndihmojë që të filloni bisedën. Ju mund të kërkonti një vizitë jozyrtare në hospis, çka mund t'ju ndihmojë të zgjidhni mes shërbimeve të ndryshme hospis.

Pyesni për hospis në zonën tuaj.



Nonprofit corporations and independent licensees of the Blue Cross and Blue Shield Association

A është
HOSPIS
zgjedhja e duhur për
PERSONIN TIM
TË DASHUR
dhe për mua?





ÇFARË ËSHTË HOSPIS?

Hospis ofron kujdes, komfort dhe mbështetje për personat që jetojnë me një sëmundje të rëndë.

SI MUND TA DIMË QË HOSPIS ËSHTË ZGJEDHJA E DUHUR?

Ndonjëherë kimioterapia dhe trajtimet me rrezatim nuk mund ta kurojnë më kancerin. Qëllimi i hospis është që të ndihmojë personin tuaj të dashur që të arrijë cilësinë më të mirë të mundshme të jetës në muajt, javët dhe ditët e fundit.

Profesionistët e hospis menaxhojnë simptomat, si dhimbja, të përzierat dhe vështirësia në frymëmarrje. Ata mund të ndihmojnë në reduktimin e ankthit dhe ofrojnë mbështetje shpirtërore dhe emocionale. Fokusi është te dhënia e ndihmës që personi juaj i dashur të jetojë më gjatë, në mënyrë komode dhe me dinjitet.

Hospis nuk do të thotë se po heq dorë. Personi juaj i dashur do të vazhdojë të marrë cilësinë më të lartë të kujdesit ndërkohë që është në hospis.

KUR DUHET TË FLAS ME PERSONIN TIM TË DASHUR RRETH HOSPIS?

Vendosja se kur duhet të marrësh në konsideratë shërbimin hospis për një person të dashur me sëmundje të rëndë mund të jetë e vështirë.

Është normale të përballesh me emocione të forta dhe të kesh frikë për të ardhmen. Vendimi mund të jetë i vështirë, por diskutimi i këtyre pyetjeve me të dashurin tuaj mund t'ju ndihmojë të filloni bisedën

- Çfarë dëshiron të përjetosh në ditët tua të fundit?
- Me kë dëshiron të kalosh kohë?
- Çfarë qëllimesh ke?
- A është kujdesi në hospis një opsion që dëshiron ta marrësh në konsideratë?
- Çfarë do të thotë për ty të jesh në hospis?

ÇFARË NDODH ME PERSONIN TIM TË DASHUR NËSE REGJISTROHET NË NJË HOSPIS?

Gjatë kohës që është në hospis, personi juaj i dashur do të-

- Vazhdojë të marrë kujdes për probleme të tjera që mund të ketë, si p.sh. diabeti.
- Vazhdojë të marrë barna për dhimbjen, antibiotikë dhe barna të tjera për të cilat ka nevojë.
- Jetë në gjendje të kontaktojë me onkologun e tij dhe me mjekun e familjes.
- Marrë mbështetje emocionale, psikologjike dhe shpirtërore.

KU OFROHET HOSPIS?

Kujdesi do të ofrohet kudo që ju jetoni (p.sh. në shtëpi, në shtëpinë e një miku, në një shtëpi të moshuarish të pajisur me staf të specializuar, në një qendër rezidenciale kujdesi, qendër kujdestarie për të rritur, në një shtëpi ku ofrohet hospis). Ju mund të kontaktoni hospice për mbështetje 24 orë në ditë, 7 ditë në javë me anë të telefonit.